

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Nr. i dokumentit. 21.11.1-2009-08

RAPORT I AUDITIMIT

TË PASQYRAVE FINANCIARE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

PËR FUNDVITIN 31 DHJETOR 2009

Prishtinë, Qershor 2010

Tabela e përmbajtjes

I. Përmbledhje e përgjithshme

II. Hyrje

III. Objektivi i Auditimit dhe Fushëveprimi

IV. Qasja e auditimit

V. Opinioni i auditimit

VI. Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)

II. Komentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Vlerësimet e ZAP

III. Raporti përcjellës në implementimin e rekomandimeve për shpërndarjen e barnave esenciale nga Departamenti Farmaceutik-Ministria e Shëndetësisë.

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
AKPM	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
LVTH	Llogaria e Vetme e Thesarit
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
LPP	Ligji Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik ne Kosovë Me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr. 02/L-99
LE	Lista Esenciale
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MEF	Ministria Ekonomisë dhe Financave
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
ORL	Otorolaringologjia
PF	Pasqyrat Financiare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzimi administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të MSH-së për periudhën që ka përfunduar me 31dhejtor 2009. Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t'u tërheqim vëmendjen se pasuritë fikse nuk janë shpalosur plotësisht.(ISSAI 400 ***Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).***

Auditimi ynë i pasqyrave financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi në disa fusha, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i organizatës.

Auditimi i kryer ka shpalosur një numër rastesh të kontrolleve të dobëta në gjithë organizatën të theksuara në pjesën VII. Dobësitë e identifikuara në këtë raport bëjnë të konkludojmë që:

Nevojiten përmirësime sidomos në lidhje me:

- Pasqyrat financiare të MSH-së të përgatiten plotësisht në pajtim me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të Sektorit Publik për sa i takon"Raportimit Financiar mbi Bazat e Kontabilitetit të Parasë së gatshme" dhe UA të MEF që nxirren në fund të çdo viti fiskal;
- Rritjen e kontrolleve për përcjelljen e procesit të shpërndarrjes së barnave prej furnizimit deri në ofrimin e shërbimit pacientëve, si dhe vendosjen e barnave në hapësira të sigurta nga humbja dhe dëmtimi;
- Ti kushtohet një vëmendje të vecantë në rritjen e cilësisë së proceseve të prokurimit dhe ato të kontrollit; dhe
- Nevojiten veprime shtesë për të forcuar kontrollet mbi menaxhimin e pasurive të MSH-së.

Një raport i veçantë përcjellës mbi atë se si i ka adresuar Ministria rekomandimet të dhëna në raportin e performncës "Shpërndarja e listës esenciale të barnave nga Departamenti Farmaceutik" të vitit të kaluar është bashkangjitur në Shtojcën 3 të këtij raporti.

Menaxhmentit të MSH i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund t'i gjeni në Shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme", në përputhje me Udhëzimin Administrativ 20/2009 dhe ato t'i prezantoj me kohë.

III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim i MSH-së iu referohet pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2009.
Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

IV. Qasja e auditimit

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është më konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Ne kemi analizuar qasjen tonë të auditimit sipas katër fushave kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollet e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, në kërkojmë të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollet monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe

- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollet e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lart, në dokumentojmë kontrollet e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, (siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënia jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si:

- mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare;dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e MSH-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të MSH-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të MSH-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
3. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të 1%, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike; rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MSH- së.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të MSH-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

V. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të MSH-së për periudhën që ka përfunduar me 31dhejtor 2009. Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t'u tërheqim vëmendjen se pasuritë fikse nuk janë shpalosur plotsisht.(ISSAI 400 ***Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).***

VI. Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar

Raporti ynë i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2008 kishte dhënë 18 rekomandime. Prej tyre, tri janë implementuar plotësisht, dy pjesërisht, ndërsa tjerat nuk janë adresuar. Rekomandimet më kryesore që nuk janë implementuar janë paraqitur në vijim dhe kanë të bëjnë me çështjet:

a) Komisioni për pranim teknik të pajisjeve të bëj testimet e duhura të aparaturave në bazë të specifikacionit të kontratës për tu siguruar se janë paguar aparaturat e kërkuara në kontratë dhe futjen e aparaturave në funksion;
b) Për përmbushjen e plotë dhe me kohë të kontratave të nënshkruara dhe për rastet e vonesave në realizimin e tyre, të aplikohen penalet;
c) Depoja të sillet në kushtet e pranueshme sipas standardeve për ruajtjen e barnave;
d) Që Departamenti farmaceutik të hetoj dështimet në zinxhirin e furnizimit me barna; dhe
e) Rekomandimi për regjistrimin e pasurisë në sasitë faktike dhe sipas vlerave financiare.

Niveli i adresimit të rekomandimeve të mëhershme ngritt shqetësime. Pa e bërë këtë, mangësitë e theksuara do të ekzistojnë. Aty ku çështjet konsiderohen ende të rëndësishme, ato janë përsëritur në seksionet më poshtë.

Një raport i veçantë përcjellës mbi atë se si i ka adresuar Ministria rekomandimet të dhëna në raportin e performncës "Shpërndarja e listës esenciale të barnave nga Departamenti Farmaceutik" të vitit të kaluar është bashkangjitur në Shtojcën 3 të këtij raporti.

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

VII.1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1 : Përshkrimi i Buxhetit dhe Shpenzimeve

Të Hyrat/Shpenzimet	2009 Buxheti fillestar	2009 Buxheti rishikuar	2009 Buxheti final	2009 Aktuali	2008 Aktuali	2007 Aktuali
Granti Qeveritar	66,282,033	74,095,483	74,095,483	71,288,733	61,411,763	48,793,408
Të hyrat vetjake	-	-	4,031,725	3,098,001	-	-
Granti i jashtëm	-	-	1,993,847	1,207,604	-	-
Totali	**66,282,033**	**74,095,483**	**80,121,055**	**75,594,338**	**61,411,763**	**48,793,408**
Pagat dhe mëditjet	20,272,409	21,942,349	26,222,776	25,163,045	20,273,327	19,867,105
Mallrat dhe shërbimet	29,293,131	33,326,531	34,235,142	31,687,552	27,580,153	20,597,921
Komunalitë	3,146,073	3,446,073	3,450,531	3,360,636	3,336,639	2,368,547
Subvencione dhe trannsfere	1,070,420	2,452,430	3,107,298	3,031,449	2,777,079	760,122
Shpenzimet kapitale	12,500,000	12,928,100	13,105,309	12,351,686	7,444,565	5,199,713
Totali i shpenzimeve	**66,282,033**	**74,095,483**	**80,121,056**	**75,594,338**	**61,411,763**	**48,793,408**
Bilanci	-	-	-	-	-	-

Në kolonën e tretë të tabelës, shihet se buxheti final ishte 80,121,056€, për rreth 6,025,573€ më i lartë se buxheti i rishikuar. Pjesa e madhe e diferencës arsyetohet me faktin se të hyrat vetjake dhe donacionet e jashtme nuk kanë mundur të parashikohen kur buxheti është aprovuar.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2009 ishin rreth 75,594,338€ apo mbi 94% të buxhetit final. Ne kemi vërejtur tendencën e rritjes së shpenzimeve në fund të vitit financiar, ashtu që vetëm në tremujorin e fundit ato arrin deri në 43 % nga shpenzimet e përgjithshme.

Konkluzion

Ministria ka shpenzuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2009 përbrenda limiteve të përcaktuara nga ana e Kuvendit dhe mund të thuhet se ishte ndër subjektet më të suksesshme në zbatimin e buxhetit.

VII.2 Pasqyrat financiare

VII.2.1 Cilësia e informatave

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po i raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

- Pasqyrat Financiare të MSH-së për vitin 2009 nuk janë plotësisht të sakta, meqë përmbajnë informacione të gabuara ose jo të plota për shpenzimet;
- Avancet e pa mbyllura për udhëtime zyrtare janë në vlerë prej 86,000 €, ndërsa tek paraja e imtë, avancet e pa mbyllura janë 2,510€;
- Pasuritë nuk janë prezantuar plotësisht në Pasqyra Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2009; dhe
- Regjistri kontabël i pasurisë nuk është i plotë dhe i saktë;

Tabela 2: **Krahasimi i shpenzimeve sipas Thesarit me PF sipas kategorive ekonomike**

Në Euro (€)

Përshkrimi	Shpenzimet sipas PF	Shpenzimet sipas Thesarit	Diferenca
Paga dhe Mëditje	25,163,045	25,182,645	19,600
Mallra dhe Shërbime	31,687,522	31,958,263	270,741
Shpenzimet e Komunalive	3,360,636	3,352,103	(8,533)
Subvencione dhe Transfere	3,031,449	3,025,094	(6,355)
Investime Kapitale	12,351,686	12,359,686	8,000
Totali	**75,594,338**	**75,877,791**	**283,453**

Më tutje, kemi vërejtur diferenca në mes të dhënave të prezantuara në Pasqyra Financiare nga MSH dhe të raporteve të prezantuara nga Thesari për shpenzimet e realizuara sipas kodeve burimore.

- Pagesat e realizuara nga burimet e të hyrave vetjake (fondi burimor 21) sipas P/F janë 2,660,169€, ndërsa sipas raporteve të Thesarit 2,761,318€, që rezulton më një diferencë 101,147€;
- Pagesat e realizuara prej të hyrave të bartura nga viti paraprak sipas P/F janë 437,832 €, ndërsa sipas raporteve të Thesarit 336,683 €. Diferenca 101,150 €;
- Në nenin 9 në Pasqyrën e pranimit dhe pagesave në para të gatshme nuk janë prezantuar pagesat për shpenzime kapitale, siç kërkohet nga UA-20/2009 - Për raportimin vjetor të organizatave buxhetore; dhe
- Në pjesën V të pasqyrave financiare, për pagesat e granteve dhe të hyrave vetjake nuk janë bërë shpalosjet.

VII.2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Kërkesat në LMFPP nr. 03/L-048 si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 20/2009 ne kemi identifikuar pikat në vijim:

1 Pasqyrat Financiare nuk janë përgatitur në përputhshmëri të plotë me UA 20/2009 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore;
2 Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
3. Pasqyrat Financiare nuk janë nënshkruar brenda kornizës kohore, janë dorëzuar më datën 03.02.2010;
4. Pasqyrat Financiare janë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
5. Ministria e MSH nuk ka ofruar dëshmi për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2009.

Konkluzion

Për shkak të mungesës se barazimeve të rregullta ndërmjet raporteve të Ministrisë dhe raporteve të Thesarit, të cilat u ceken më lartë, konkludojmë se Ministria nuk ka arritur ti përgatisë pasqyrat financiare plotësisht në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Rekomandimi 1
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Harmonizimet e rregullta të raporteve të MSH dhe raporteve të Thesarit sipas kodeve burimore dhe ekonomike dhe te shpjegohen arsyet ne rastet kur ka mosharmonizime; dhe
- Që Pasqyrat financiare të jenë plotësisht në pajtim me SNKSP dhe Udhëzimet administrative dhe rregulloret mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore.

VII.3 Realizimi i Buxhetit

VII.3.1 Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat e planifikuara sipas MSH për vitin 2009 ishin 4,031,725€, ndërsa janë realizuar në shumën prej 3,098,001€. Në këtë shumë ja në të përfshirë edhe të hyrat e bartura nga viti 2008.

Inkasimi i të hyrave nga participimi në QKUK nuk ishte bërë përmes llogarisë bankare

Ne kemi vërejtur se të hyrat për shërbimet shëndetësore mbi shumën 10€ nuk ishin inkasuar përmes llogarisë bankare,siç janë dëftesa nr. 0096608 në shumën prej 25€, dëftesa nr. 0083201 në shumën prej 40€, etj.

Konkluzioni

Mos inkasimi i parave për shërbimet shëndetësore për mes llogarisë bankare rrit rrezikun që të hyrat të mos evidentohen dhe depozitohen të gjitha në llogaritë bankare.

Rekomandimi 2
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj që:

- Të hyrat e inkasuara mbi shumën prej 10€ për shërbimet shëndetësore të bëhen përmes llogarisë bankare.

VII.3.2 Menaxhimi i shpenzimeve

VII.3.2.1 Paga dhe mëditje

Buxheti për paga dhe mëditje ishte 26,222,776€, ndërsa sipas shënimeve të PF-ve në këtë kategori janë shpenzuar 25,163,045€ ose në masën 96% . MSH gjatë vitit 2009 kishte 7409 të punësuar me kontratë të rregullt. Për të vlerësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm në menaxhimin e dosjeve të personelit, pagesat e pagave dhe procedurat e rekrutimit të punëtorëve të rinj, kemi përzgjedhur për mostrim 22 dosje të personelit.

Gjatë testimit të mostrave të përzgjedhura kemi identifikuar mangësitë në vijim

Nga dosje të testuara në administratën Qendrore kemi vërejtur se në pesë raste nuk figuron numri i kontratës si dhe pozita e përshkruar në kontratë.

Konkluzioni

Me përjashtim të numrit të kontratave si dhe pozitës se përshkruar në kontratë në vlerësojmë se shpenzimet për paga dhe mëditje ishin menaxhuar në mënyre të duhur.

VII.3.2.2 Mallra dhe shërbime

Buxheti final për kategorinë Mallra dhe Shërbime për vitin 2009 ka qenë në shumë prej 34,235,142€, ndërsa shpenzimet aktuale sipas Thesarit ishin 31,687,552€ ose në masën 92%.

Administrata Qendrore e MSH

Produktet e pranuara për hemodializë nuk janë në pajtueshmëri të plotë me specifikat e përcaktuara në kontratë

Në kontratën për furnizim me produkte të hemodializës, Granudial AF10, në vlerë prej 532,485€, ne kemi vërejtur se produktet e pranuara në dy raste, (në vlerë 321,285€) nuk ishin në pajtueshmëri me specifikat e përcaktuara në kontratë. Produktet e pranuara sipas raporteve të komisionit të pranimit janë Granudial AF12.
Duke i shmangur problemet e këtilla, specifikacionet duhet bërë në atë mënyrë që të fokusohet në nevoja e jo në produkt me përqindje të caktuar të përbërësit.

Pranimi i produkteve medicinale nuk është bërë nga personat kompetent

Sipas UA të MSH nr. 12/2005 mbi procedurat për pranimin e Barnave, Materialit Shpenzues, Produkteve të Hemodializës dhe Pajisjeve Medicinale, në përbërje të komisionit për pranim-dorëzim të produkteve medicinale në deponë qendrore duhet të jetë edhe përfaqësuesi i kompanisë distribuese për barnat e listës esenciale. Ne kemi vërejtur se në shtatë raste të furnizimit me barna në vlerë 881,512€, përfaqësuesi i kompanisë distribuese nuk ka qenë pjesë e komisionit të pranim-dorëzimit .

Tejkalim i limiteve të përcaktuara për shpenzimet e telefonisë fikse

Gjatë auditimit të shpenzimeve të telefonisë fikse kemi ekzaminuar dhjetë numra të telefonave në Administratën Qendrore për vitin 2009 dhe kemi vërejtur tejkalim të shpenzimeve mbi limitet e përcaktuara me UA nr. 04/2008 mbi përdorimin e telefonave në Qeverinë e Kosovës. Vlera e lejuar për Shpenzime të telefonisë fikse për vitin 2009 ishte 3,310€, ndërsa shpenzimet e realizuara ishin 5,455€. Tejkalimi i limitit të përcaktuar ishte 2,146€.

Konkluzioni

Mungesa e sistemit adekuat të kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të produkteve medicinale rritë rrezikun që produktet e pranuara të mos jenë të kualitetit dhe kuantitetit të duhur.

Më tutje, MSH nuk ka kontrolle të përshtatshme të cilat në mënyrë të arsyeshme sigurojnë se shpenzimet e telefonisë fikse realizohen në bazë të limiteve të përcaktuar nga UA-04/2008 Mbi përdorimin e telefonave në Qeverinë e Kosovës.

Rekomandimi 3
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj që:

- Të forcoj sistemin e kontrolleve të brendshme që siguron se mallrat ose barnat e pranuar të jenë në pajtueshmëri me specifikat e kërkuar në kontratë,Për pranimin e produkteve tjera të cilat nuk janë pajtim me specifikat e kërkuara në kontrate duhet të shpjegohen arsyet e pranimit;
- Barnat të pranohen nga personat kompetent në pajtueshmëri me udhëzimin administrativ nr. 12/2005; dhe
- Menaxhmenti duhet të forcoj kontrollet e brendshme për shpenzimet e telefonisë fikse, më qëllim që të sigurojë veten se shpenzimet e telefonisë fikse realizohen në pajtim më UA Nr. 04/2008 Mbi përdorimin e telefonave në Qeverinë e Kosovës. Po ashtu, të gjithë zyrtarët e Ministrisë të cilët e kanë tejkaluar kuotën e lejuar të shpenzimeve të telefonisë t'i kthejnë paratë në BKK.

VII.3.3.3 Investimet Kapitale

Administrata Qendrore e MSH-së

Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre ofertuesve të përgjegjshëm

Të lënda Renovimi e kulmit në Institutin e Onkologjisë në vlerë 37,983 € kemi vërejtur se është përzgjedhur Operatori Ekonomik fitues, përkundër mungesës së tri ofertave të përgjegjshme. (dy nga tre operatorët ekonomik nuk kanë pasur licenca).

Vonesa në kryerjen e punimeve

Gjatë rishikimit tonë, kemi vërejtur se operatorët ekonomik nuk e kanë respektuar planin dinamik për ekzekutimin e punimeve.

Vonesa në kryerjen e punimeve kemi vërejtur në tri raste siç janë:

- Kontrata për renovimin e ndërtesës së kardiokirurgjisë në vlerë prej 633,121€ është nënshkruar me datën 24.11.2008. Afati për kryerjen e punimeve ishte 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Kontrata për Adaptimin e hapësirave për instalimin e aparaturave të radiologjisë në shumë prej 182,063€ është nënshkruar me datën 05.12.2008. Afati kohor për përfundimin e punimeve ishte jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Kontrata e nënshkruar me datën 29.09.2009 për Ndërtimin e Ambulantëve në: Mazgit, Rashanë,Vasilevë në vlerë prej 116,704€ sipas kontratës ishte paraparë që punimet të kryhen në afat prej 59 ditëve.

Nga tri kontratat e cekura më lartë deri në përfundim të fazës audituese më datën 22.03.2010 nuk na është ofruar dëshmi se punimet në këto projekte kanë përfunduar.

Çmimi i ofruar në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit përmbante një gabim matematikor në vlerë rreth 200,000 €

Gjatë auditimit të kontratës renovimi e klinikës së kardiokirurgjisë në vlerë 633,121€, kemi vërejtur se fillimisht operatori ekonomik kishte ofruar çmimin në total 434,622€. Komisioni i vlerësimit të ofertave duke i analizuar çmimet për njësi dhe sasi ka ardhur në përfundim se duhet të bëhet korrigjimi i ofertës dhe shuma e ofertës në total duhet të jetë 633,121€. Kjo shumë e përshtatur shumë afër dy konkurruesve tjerë. Kontrata është nënshkruar me operatorin ekonomik në atë nivel.

Çertifikimi i pagesave

Zyrtari Certifikues në kuadër të administratës qendrore të MSH-së, kishte çertifikuar 26 lëndë për pagesë në vlerë prej 4,920,257€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, edhe pse nuk e ka pasur nënshkrimin e deponuar në Thesar për çertifikimin e pagesave.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Punimet e papërfunduara sipas kontratës (Ndërrimi i destinacionit të fondeve pa aprovim paraprak)

Kontrata për renovimin e dyshemesë në klinikën e ORL, Kirurgjia plastike maksilofacile ishte në vlerë prej 29,257€. Sipas komisionit për pranimin teknik, vlera e punimeve të përfunduara ishte 20,250€ aq sa ishin bërë edhe pagesat. Vlera e punëve të pa përfunduara në vlerë prej 9,000€ është investuar në repartin e Oftalmologjisë dhe në një dhomë të ortopedisë, pa e pasur aprovimin përkatës për ndërrimin e destinacionit të mjeteve.

Nënshkrimi i kontratave pa fonde të zotuara

Nga auditimi i këtyre lëndëve kemi vërejtur se në tri raste për investime kapitale janë nënshkruar kontratat para zotimit të fondeve, siç janë:

- Kontrata për furnizim me pajisje medicinale në shumën prej 266,449€;
- Kontrata për klimatizimin dhe ventilimin e sallave të operacionit në QKUK në vlerë prej 1,221,675€; dhe
- Kontrata për furnizim me pajisje dhe material për rrjetin e avullit dhe nënstacioneve të ujit të ngrohtë sanitar në QKUK në vlerë prej 1,804,698€.

Devijime nga specifikacioni teknik dhe kontrata

Në kontratën për rikonstruimin e klinikës së Neurologjisë, pozicioni për punët e dyshemesë në vlerë prej 20,624€ nuk është realizuar në bazë të specifikacionit teknik dhe kontratës. Sipas komisionit të pranimit teknik materiali për punët e dyshemesë nuk është i njëjte e as ekuivalent me atë të përcaktuar në specifikacionin teknik.

Certifikimi i pagesave

Pagesa për adaptimin e hapësirave për instalimin e aparaturave të radiologjisë është çertifikuar në vlerë prej 8,399€, edhe pse mjetet kanë qënë të destinuara për renovimin e klinikës së kardiokirurgjisë.

Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale (AKPM)

Mungesa e dëshmive për pagesat e realizuara për tri kontrata në AKPM

AKPM nuk ishte në gjendje të ofroj dokumentacionin e nevojshëm (Urdhër pagesat, faturat dhe raportet e pranimit) për pagesat e realizuara në vlerë prej 90,000€ siç janë;

- Pagesat për renovimin e kulmit të ndërtesës së AKPM-së në vlerë 73,000€;
- Pagesat e naftës 7,000€, si dhe;
- Pagesa për projektin "Ribona Konsultë" në vlerë 10,000€.

Konkluzion

Rastet e përshkruara më lart flasin për dështime në proceset e kontrollit të brendshëm nga ana e MSH-së. Investimet për projekte kapitale nuk menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente. Kontrollet e brendshme të MSH nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se procedurat e prokurimit zbatohen në pajtim me kërkesat ligjore. Dështimet në zbatimin e rregullave të prokurimit kanë mundur të ekspozojnë MSH para rrezikut që fondet publike të jenë shpenzuar jo racionalisht, madje përmbajnë elemente të keqpërdorimeve.

Rekomandimi 4
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj se:

- Të formoj një grup punues brenda Ministrisë dhe në hollësi t'i hetoj të gjitha rastet nën pikën VII. 3.3 të këtij raporti. Pas këtij hetimi, varësisht nga gjetjet, të ndërmerr masat përkatëse;
- Të anuloj të gjitha aktivitetet e prokurimit nëse nuk plotësohet një nga kriteret parësore të konkurrencës - pranimi i më së paku tri ofertave të përgjegjshme; Aplikimin në mënyre të drejt të dënimeve kur kontraktuesi nuk përfundon projektin në kohen e paraparë më kontratë;
- Të forcohen masat e kontrollit tek vlerësimi i ofertave dhe të eliminohen mundësitë e keqllogaritjeve apo gabimeve në shifra tek ofertat e pranuara; Që punimet të realizohen sipas kontratës dhe në përputhshmëri me specifikacionin teknik të dosjes së tenderit;dhe
- Që të zhvilloj një hetim të mëtutjeshëm për pagesat të cilat AKPM nuk ka qene në gjendje t'iu ofrojë auditorëve gjatë punës në teren.

VII.4 Menaxhimi i Prokurimit

Të gjeturat e raportuara në nën-kapitujt e mësipërm demonstrojnë se MSH-ja ka ndërmarrë procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik nr. 2003/17.

Konkluzion

Dështimet në implementim dhe kontrollit të proceseve të prokurimit tregojnë që Ministria nuk e ka shpenzuar buxhetin në mënyrë të arsyeshme, dhe është rruga për keq menaxhim dhe keqpërdorim.

Rekomandimi 5
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Të rishikoj thellësisht sistemet e kontrolleve si dhe implementimin e tyre. Aty ku kontrollet janë të dobëta apo nuk ekzistojnë fare, të njëjtat të forcohen apo vendosen më shumë masa të kontrollit, në mënyrë që procesi i prokurimit të jetë nën monitorim të plotë;dhe
- Marrjen e masave të duhura kur zyrtarët nuk i kryejnë funksionet e deleguara ashtu si duhet.

VII.5 Menaxhimi i Pasurive

Pasuritë fikse

Mungesa e regjistrit gjithëpërfshirës të pasurive

Dobësi janë identifikuar edhe në menaxhimin e pasurive si në vijim:

- Në regjistrat e pasurive të përgatitur nga MSH nuk janë përfshirë të gjitha pasuritë në aspektin sasior dhe financiar. Disa prej automjeteve nuk janë paraqitur në pasqyra financiare;
- Zyrtarit i Pasurive në AKPM nuk ka qasje në regjistrimin e pasurive në Thesar;
- Në deponë e Mazgitit ende gjenden barna edhe përkundër vendimit që të gjitha barnat të largohen nga ky lokacion , ndërsa produktet e hemodializës në QKUK janë të vendosura në hapësira të korridoreve në Gjinekologji; dhe
- Objekti i Onkologjisë nuk është futur në funksion gjatë vitit 2009.

Konkluzioni

Ministria për vitin 2009 nuk ka regjistër përfundimtar mbi pasuritë e saj, respektivisht nuk ka menaxhuar pasuritë e saj në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Mungesa e evidencave të pasurive ndikojnë negativisht në prezantimin e pasqyrave financiare si dhe rrit ekspozimin e përgjithshëm të Ministrisë para rrezikut të humbjes apo keqpërdorimit të pasurive publike.

Rekomandimi 6
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Regjistrimin e menjëhershëm të gjitha pasurive fikse në pajtim me kërkesat e Udhëzimit Administrativ, nr. 21/2009 në aspektin sasior dhe financiar;
- Ndarje të drejt të detyrave dhe përpilimin e një regjistri të plotë dhe të saktë për të gjitha pasuritë që janë në kuadër të MSH-së;
- Hapësirë të mjaftueshme dhe të sigurt për vendosjen e barnave, për të eliminuar mundësitë nga humbja dhe dëmtimi i tyre; dhe
- Vënien e objektit të Onkologjisë në funksion dhe aparaturës mjekësore që gjendet në këtë objekt sa më parë.

VII.6 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Ne kemi identifikuar menaxhim dhe kontroll të dobët në fushat e paraqitura në seksionet më lartë siç janë: Dështimi në implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të pasqyrave financiare, është tregues i qartë se dobësitë nga viti i kaluar janë akoma evidente.

Konkluzion

Dobësitë e identifikuara në sistemet e kontrollit të brendshëm janë identifikuar, në gjithë organizatën që janë theksuar në pjesën VII bëjnë të konkludojmë që kontrolli i brendshëm përbrenda MSH-së, nuk është dizajnuar si i tillë nuk mjafton për të ofruar siguri në përmbushjen e objektivave të menaxhmentit. Në përgjithësi, konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar është joadekuat dhe duhet të përmirësohet duke i adresuar rekomandimet te nxjerra së bashku me implementimin e atyre të dala nga viti paraprak.

VII.7 Auditimi i Brendshëm

Një Njësi funksionale dhe e pavarur e Auditimit të Brendshëm (NjAB) duhet të jetë pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm meqë mund të ofrojë siguri menaxhmentit rreth përshtatshmërisë së kontrolleve të sistemit dhe të japë rekomandime për përmirësim.

Një nga objektivat e auditimit ishte të vlerësohet pavarësia dhe cilësia e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për të përcaktuar nëse auditimi i brendshëm përmbushë funksionin e tij. Gjatë auditimit kemi shqyrtuar raportet dhe të gjeturat e kryera nga NJAB për të përcaktuar nëse mund të mbështetmi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë. MSH-se ka dy njësi të auditimit njërën në kuadër të administratës qendrore të MSH-së dhe njërën në kuadër QKUK-së. MSH ka të themeluar komisionin e auditimit të brendshëm dhe janë takuar rregullisht në vitin 2009.

NJAB ka përgatitur një raport lidhur me aktivitete e auditimit të brendshëm, planin vjetor për vitin 2009 si dhe ka përgatitur planin strategjik për vitet 2009 -2010. NJAB në kuadër të administratës qendrore ka finalizuar 12 raporte gjatë vitit 2009. Prej tyre shtatë raporte përfshinin periudhën e vitit 2009, ndërsa pesë raporte përfshin periudhën e vitit 2008.

NJAB për periudhën e vitit 2009 kryesisht ishe fokusuar në fushat siç janë: Procedurat e shpenzimeve dhe procedurat e të hyrave vetjake, auditimi i deposë së barnave në spitalin rajonal të Gjilanit, Procedurat e shpenzimeve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2009, procedurat e shpenzimeve për vitin 2009 në spitalin e Vushtrrisë, Mitrovicës, Ferizajt dhe për Deponimin evidentimin dhe shpërndarjen e barnave.

NJAB në kuadër të QKUK ka finalizuar tetë raporte gjatë vitit 2009. Prej tyre tri raporte ishin për periudhën e vitit 2009, ndërsa pesë raporte përfshinin periudhën e vitit 2008. NJAB për periudhën e vitit 2009 kryesisht është fokusuar në fushat siç janë: Raporti i rishikimit të procesit të pranimit dhënies dhe shpërndarjes së qumështit, djathit dhe konservave "TUNA" dhe deponë qendrore në QKUK. Procesi i regjistrimit kalkulimit pagesës së kujdestarive dhe pagesës së shujtës dhe Mallra dhe shërbime.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se NJAB ka kryer auditime të kontratave me vlera të vogla dhe të mesme. NJAB nuk ka fokusuar aktivitetet e saja në fushat me rrezik të lartë, siç është prokurimi dhe ekzekutimi i kontratave më vlera të mëdha.

Rekomandimi 7
Rekomandojmë Ministrin e MSH të siguroj:

- Që NJAB në auditimet e ardhshme të përfshij tërë procesin e prokurimeve, në veçanti kontratat me vlera të mëdha, si dhe të auditohen fusha të cilat paraqesin rrezik të lartë;
- NJAB të fokusohet në rishikimin e aktiviteteve të vitit aktual, të ndjek proceset në zhvillim, me qëllim të përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të mban të informuar menaxhmentin mbi përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme; dhe
- Komisioni i Auditimit të merr masa për forcimin e auditimit të brendshëm dhe të ndikimit të tij.

VII.8 Një Konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Ministrisë

Konkluzionet e përgjithshme dhe rekomandimet

Dobësitë e identifikuara në kuadër të këtij raporti në lidhje me kualitetin e informatave, sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të pasurive kanë shpie në konkluzionin e përgjithshëm se Ministri ka nevojë të bëj përpjekje në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kontrollin menaxherial.

I rekomandohet Ministrit të rishikoj sistemit të kontrolleve si dhe të propozoj një pako masash për përmirësimet e nevojshme menaxheriale brenda Ministrisë.

Përmirësime nevojiten sidomos në lidhje me:

- Pasqyrat financiare të MSH të përgatiten plotësisht në pajtim me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të Sektorit Publik për sa i takon"Raportimit Financiar mbi Bazat e Kontabilitetit të Parasë së gatshme" dhe UA të MEF që nxirren në fund të çdo viti fiskal;
- Rritjen e kontrolleve për përcjelljen e procesit të shpërndarjes së barnave prej furnizimit deri në ofrimin e shërbimit pacientëve, si dhe vendosjen e barnave në hapësira të sigurta nga humbja dhe dëmtimi;
- Ti kushtohet një vëmendje të veçantë në rritjen e cilësisë së proceseve të prokurimit dhe ato të kontrollit; dhe
- Nevojiten veprime shtesë për të forcuar kontrollet mbi menaxhimin e pasurive të MSH-së

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400).

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:
(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuara të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:
(a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustifikuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
(c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse

efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinioni që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2

Menaxhmentit të MSH-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Komentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Vlerësimet e ZAP

Nr.	Referenca	Komentet e MSH-së	Vlerësimet e ZAP
1.	**VII. 2.1 Cilësia e informatave**	Më që specifika për edukim të vazhdueshëm profesional dhe ndarja e këtyre mjeteve bëhet përmes Bordit përkatës dhe këto nuk duhet të llogariten si avanse dhe nuk varen nga shpenzimet e krijuara si dhe nuk llogariten mëditje, është ndarje fikse me qellim te mundësimit për edukim profesional, e jo për udhëtim zyrtar dhe mbyllja e tyre varet nga sjellja e dokumentacionit përkatës financiar, për cka shume pjesëmarrës që e gëzojnë ketë të drejte nuk kane sjelle dokumentacionin përkatës financiar. Veprimet e ndërmarra dhe kërkesat e bëra në MEF që kjo kategori duhet të jete si subvencion dhe mbyllja e tyre të bëhet në momentin e lëshuarjes se pagesës. është në diskutim në MEF dhe presim ndonjë përgjigje. Disa lënde të avanseve të hapura janë dërguar në Thesar (lendet për te cilat marrësit e avanseve i kane sjelle dokumentacionin për mbyllje), mirëpo Thesari nuk e ka bërë mbylljen dhe i ka kthyer lëndët, duke kërkuar forma të tjera të mbylljes me formularë të tjerë, që kërkohet në ata formularë edhe pjesa e mëditjeve (të cilat mëditje nuk mund të aplikohet për këto raste pasi qe këtu ka të bëjë me edukim profesional dhe ndarje fikse nga ana e Bordit dhe nuk është udhëtim zyrtar. Po te ishte kështu, atëherë shpenzimet e mëditjeve kishin për të përfshire shuma te mëdha qe këto trajnime zgjasin). Kjo qëndron për shkak të problematikave rreth mënyrës së mbylljes dhe kohëzgjatjes se edukimit profesional. Ndërsa lidhur me atë se shuma prej 2,510€ si avans, do të duhej që të definohet se në cilin program buxhetor ka ndodhur, me qellim të identifikimit, në administrate e MSH. Avanset e parave të gatshme janë të gjitha të mbyllura.	Në UA nr. 20/2009 për raportim vjetor të organizatave buxhetore sipas nenit 14. Avancet e dhëna si para të gatshme duhet të mbyllen dhe arsyetohen deri me datën 15 janar 2010. Nga dëshmitë e ofruara me komente ne nuk kemi gjetur elemente të mjaftueshme për ndryshimin e konkluzioneve tona të auditimit. Andaj të gjeturat dhe konkluzione auditimit mbesin të pandryshuara.

2.	**VII.2.1 Cilësia e informatave**	Koment rreth krahasimit të realizimit të pagesave dhe mos barazimit të hyrave vetjake të vitit 2008 (të bartura në vitin 2009). Mos barazimi i theksuar në mes MSH dhe Thesarit nuk qëndron për arsye se diferenca prej 101,150€ është shume qe ka kaluar ne suficit dhe as në Thesar nuk figuron si shpenzim.	Edhe pas vlerësimit dhe analizës se dëshmive të ofruara me komente sa i përket pagesave të realizuara prej të hyrave vetjake te vitit 2008 të bartura në vitin 2009. Ne nuk kemi gjetur elemente të mjaftueshme për ndryshimin e konkluzioneve tona të auditimit. Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit mbesin të pandryshuara.
3.	**VII.2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**	Ndërsa, lidhur me piken 2 të rekomandimit 1, nuk ka mundësi që të dilet prej kornizës tabelare. është program i instaluar që nuk mund të ndërhyhet, prandaj Udhëzimi është respektuar. Mund të këtë ndonjë mos përfshirje të ndonjë të dhënë për shkak se MSH ka 28 programe buxhetore. Gjithashtu MSH ka raportuar pranë MEF-it për tre mujorin e pare të shpenzimeve edhe për vitin 2010 dhe do të vazhdoje edhe me tutje që raportimi për periudhat tre mujore të bëhet sipas afateve kohore dhe të përgatitura me një profesionalizëm gjithnjë e me të madh.	Në komentet e juaja ceket se mund të këtë ndonjë mos përfshirjen të ndonjë të dhënë, gjë e cila ka ndodhur për PF të vitit 2009 siç i kemi paraqitur vërejtjet për mos prezentim të saktë të disa të dhënave . Ndërsa PF kërkohet që të dhënat e prezantuara të jenë të sakta. Andaj të gjetura dhe konkluzionet e auditimit mbesin të pandryshuara.
4.	**VII.3.2.2 Produktet e pranuara për hemodialize nuk janë në pajtueshmëri të plote me specifikat e përcaktuara në kontrate.**	Në lidhje me ketë çështje, vërejtja e drejtuar AK- MSH-se, vlerësojmë se nuk është e drejte duke marre parasysh se në periudhën e pasluftës, të gjitha qendrat e Hemodializes në Kosovë kanë qene të furnizuara me **sol acidic-pluhur** të tipeve AF10, AF12 dhe AF71. Për të tri këto tipe të granualeve (sol acid pluhur) çmimet kane qenë identike, më që është i njëjti material dhe përdoret për të njëjtin qellim. Sipas nevojës se pacienteve, mjeket e kanë bërë aplikimin e tipit- tretjes se caktuar. me që këto tretje kanë nivel të kalciumit të ndryshëm. Për këtë rast që është bërë vërejtje nga ZAP, ju informojmë se oferta e ofruar nga. Prodhuesi dhe OE është e njëjtë për të tri këto tipe, andaj janë përfshire	Objektivi i auditimit tonë ka qenë viti 2009. Në kontratën e nënshkruar me datën 15.04.2009 është e specifikuar vetëm Granudial AF 10, ndërsa sa i përket çmimit sipas dëshmive të ofruara me komente është i njëjtë për granudial AF 10, AF12, dhe AF71,mirëpo në kontratë duhet të

		në të njëjtin artikull nr. 5 të ofertës. Si dëshmi për këtë i bashkëngjisim ofertën e prodhuesit dhe OE të datës 08.04.2009. I bashkangjiturë të gjitha kërkesat për vitin 2010 nga 7 Qendrat e Hemodializës, oferta e OE, njëherit edhe kontrata e nënshkruar për vitin 2010. **Prove: Dëshmitë e bashkangjitura:** • Te gjitha kërkesat për vitin 2010 nga 7 Qendrat e Hemodializes; • Oferta e OE-se; • Kontrata e nënshkruar për vitin 2010	specifikohen në mënyrë të qartë llojet me të cilat do të furnizohet MSH sepse ato ndryshojnë për kah përmbajtja e kalciumit. Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e Auditimit mbesin te pandryshuara
5.	**VII.3.2.2 Pranimi i produkteve medicinale**	Pika 1. Lidhur me këtë rekomandim është bërë ndërrimi i Depos (Depoja e re) dhe kushtet për deponimin e barnave tani janë shume më të mira se më pare. Pika 2. Pranimi i barnave është bërë dhe do të bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ 12/2005 të MSH-se, më përjashtim të një periudhe të shkurtër kohore, gjatë së cilës është bërë transferi i barnave nga depoja e vjetër në Mazgit në Depon e re në Prishtinë.	Në komentet e MSH-së pika 1 nuk ka të bëjë me rekomandimin 3, ndërsa sa i përket pikës 2 edhe pas vlerësimit dhe analizimit të dëshmive të auditimit lidhur me pranimin e barnave, ne nuk do të ndryshojmë konkluzionet tona të auditimit.
6.	**VII.3.3.3 Përzgjedhja e fituesit ne mungese të tre ofertuesve të përgjegjshëm**	Vërejtjet e dhëne ne lidhje me ketë përzgjedhje nuk qëndron, duke marre për baze faktin se për ketë tender kane ofertuar 8 ofertues, në baze të kritereve të specifikuara, 3 ofertues janë radhitur si te përgjegjshëm: 1. "Euro -Metal" - Ferizaj 2. "Mont Comercce" - Gjakove* 3. "Izolimi" - Prishtine. Ketë e dëshmon Raporti i vlerësimit i datës 01.10.2009. Për kriterin teknik/profesional te kërkuar, (çertifikat ISO ose te ngjashme, këta tre ofertues kane ofruar certifikata te tilla dhe autorizime nga prodhues ndërkombëtare* të këtyre materialeve (i gjeni te bashkëngjitura). Si AK gjate kësaj përzgjedhje jemi munduar qe te* jemi sa me racional dhe te përgjegjshëm për faktin se Instituti i Onkologjisë është një objekt me një rendësi të veçante, ne te gjinden aparatura ne vlere disa milionë euro, te cilat kane qene të rrezikuara nga rrjedhja e ujit nga kulmi dhe kupolla e objektit. Përzgjedhja e OE "Euro- Metal" si operator shume Professional, me referenca shumë bindëse dhe një nga ofertat me të lira, vlerësojmë se ka qenë shumë e	Edhe pas analizimit dhe vlerësimit të dëshmive të ofruara me komente çertifikata ISO është ofruar vetëm për kompaninë fituese ndërsa për dy kompanitë tjera të vlerësuara të përgjegjshme nga komisioni i vlerësimit nuk janë ofruar dëshmitë e çertifikatave ISO. Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit mbesin të pandryshuara.

		drejte, ka kryer një pune profesionale dhe me shumë rendësi për izolimin dhe mbrojtjen e këtij objekti.	
7.	**VII.3.3.3 Certifikimi i pagesave**	Ndërsa sa i përket certifikimit të lëndëve zyrtarja 9 certifikuese posedon kontratën si zyrtare certifikues nga viti 2007 gjerë me tani. Komente: 3,2,4 faqe 14. Zyrtarja certifikuese, të bashkangjitur ka kontratën e punës, si zyrtare për certifikim	Në komentet e MSH-së është bashkangjitur si dëshmi Kontrata për Zyrtarin certifikues, mirëpo gjatë vitit 2009 zyrtari certifikues nuk ka pasur të deponuar në thesar nënshkrimin për certifikim. Të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit qëndrojnë
8.	**VII.5 Pasuritë fikse**	Lidhur me **piken 1**, të këtij rekomandimi, dëshmojmë se te gjitha pasuritë e MSH-së janë te regjistruara në sistemin e free balancit. **Pika 2:** Synimet tona janë dhe do të jene te orientuara për të siguruar saktësi për raportime të veçanta sipas linjave. **Pika 3:** Është siguruar hapësira e re , depoja e re që i plotëson kushtet për deponimin e barnave. **Pika 4:** Veprimet do te bëhen me kohe qe ne aftin sa me te shkurtër kohor.	Pas analizimit dhe vlerësimit të të dëshmive të ofruara me komente në dëshmitë e ofruara me komente nuk janë të përfshira të gjitha pasurit në regjistrat e thesarit të cilat janë në kuadër e MSH-së . Andaj të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit mbesin te pandryshuara.
9.	**VII .7 Auditimi i brendshëm**	**<u>Rekomandimi 7</u>** Dhe 3 pikat e me poshtme: ***Prove: Bashkengjitet materiali i rekomandimit 5, Raporti i Auditorit te brendshëm.***	Në komentet e MSH-së për rekomandimin 7 nuk ka ndonjë shpjegim, në material janë ofruar raportet e auditimit të kryera nga NJAB dhe plani i implementimit te rekomandimeve të dhëna nga NJAB

Më tutje, Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca 3

RAPORTI PËRCJELLËS NË IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E BARNAVE ESENCIALE NGA DEPARTAMENTI FARMACEUTIK-MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Tabela e Përmbajtjes

I	Përmbledhje Ekzekutive
II	Hyrje
III	Objektiva studiuese dhe fushëveprimi i auditimit
IV	Historiku
V	Të gjeturat kryesore
VI	Konkluzionet

Lista e Shkurtesave

DF	Departamenti Farmaceutik
KFK	Korporata Farmaceutike e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
UA	Udhëzim Administrativ
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral

I. Përmbledhja e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka përcjellur se si MSH iu ka adresuar Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit të Përformancës për Shpërndarjen e Barnave esenciale të publikuar në Qershor 2009.
Në raportin e auditimit në Shpërndarjen e barnave esenciale nga departamenti farmaceutik në kuadër të MSH-së, kemi bërë rekomandime lidhur me përmirësimin e shpërndarjes së barnave nga lista esenciale.
Ne kemi vërejtur se: tre rekomandime janë implementuar, tre rekomandime janë implementuar pjesërisht apo janë në fazën e implementimit dhe dy rekomandime nuk kanë arritur të adresohen.

Rekomandimet e implementuara:

- Ministri i Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, duhet të bëjnë një vlerësim-planifikim më të mirë dhe më të saktë lidhur me nevojat reale vjetore për barnat të listës esenciale;
- Departamenti Farmaceutik duhet të hetoj arsyet për dështimet e dukshme në zinxhirin furnizues për barna esenciale, dhe
- Departamenti Farmaceutik duhet të siguroj që inventarizimi i pavarur i barnave esenciale në depon qendrore kryhet.

Rekomandimet pjesërisht të implementuara:

- Të gjitha kërkesat e bëra nga institucionet shëndetësore për furnizimin e barnave esenciale duhet të aprovohen nga Departamenti Farmaceutik para se ato të janë dërguar për veprim tek kompania private për shpërndarje;
- Autoritetet në Qendrën Klinike Universitare te Kosovës (QKUK) duhet të ndërmarrin veprime për ta sjell depon në kushtet e pranueshme sipas standardeve për ruajtjen e barnave, dhe
- Ministri i Shëndetësisë të inicioj një analizë të përgjithshme të procesit të shpërndarjes së barnave te pacientët dhe në bazë të saj të merr masa me qëllim të sigurimit të kualitetit në procesin e shpërndarjes. Ne rekomandojmë që si pikënisje në forcimin e procesit duhet të jetë që të mbahen regjistrime se cilat barna dhe në çfarë sasie dhe çmimi janë dërguar te çdo pacient.

Rekomandimet e pa adresuara :

- Rekomandimi lidhur me atë që Departamenti Farmaceutik duhet të nxjerr udhëzime për porositjen e barnave, përfshirë instruksionet për kalkulimin e nivelit të ri-kërkesës për çdo lloj medikamenti duke u bazuar në mesataren e përdorimit dhe kohën e drejtimit (procesi i porosisë dhe dërgesës), dhe

- Rekomandimi lidhur me atë që Departamenti Farmaceutik duhet të sigurohet se ekziston ndarja adekuate e detyrave, kështu që një individ nuk e ka plotësisht kontrollin mbi operimin e depos qendrore.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të performancës të Institucioneve Publike të Kosovës dhe mund të kryej shërbime të zakonshme plotësuese që i kryen një auditor.

Departamenti Farmaceutik (DF), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, është përgjegjës për menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes së barnave nga lista esenciale tek institucionet shëndetësore për shpërndarjen e mëtejme tek pacientët.

Po ashtu Menaxhmenti i Departamentit Farmaceutik është përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit të kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

III. Objektiva Studiuese dhe fushëveprimi i auditimit

Në këtë auditim ne kemi mbikëqyrur sa MSh-ja ka adresuar rekomandimet e dhëna në Raportin e Auditimit të Përformancës për Shpërndarjen e barnave esenciale.
Auditimi ynë ka përfshirë një vlerësim të planit të adaptuar të veprimit dhe ekzaminimin e të dhënave të tjera që kanë të bëjnë me rekomandimet e dhëna:

- Nëse organizata ka adresuar rekomandimet e dhëna;
- Nëse Plani i hartuar i Veprimit për implementimin e rekomandimeve është zbatuar nga menaxhmenti;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm, dhe
- Çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me rekomandimet e auditimit.

IV. Historiku

Departamenti Farmaceutik, brenda Ministrisë së Shëndetësisë, është përgjegjës për menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes së barnave nga 'lista esenciale' në institucionet shëndetësore për më tutje duke i shpërndarë tek pacientët. Kjo detyrë do të duhej të kryhej me Instruksionin Administrativ Nr. 2007/11 (bazuar në Ligjin e Shëndetësisë Nr. 2004/4 shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Rregullorja Nr. 2004/31 efektive nga data 27 Dhjetor 2007).
Buxheti i përcaktuar me rishikim për programin farmaceutik për vitin 2009 ishte 20 milion e 220 mijë euro , kurse për vitin 2010 buxheti është 19 milion e 54 mijë euro.

V. Të gjeturat kryesore të auditimit

Ne kemi konstatuar se menaxhmenti i MSH-së i ka cilësuar funksionale dhe të realizueshme tetë rekomandimet e dhëna nga ZAP-i në Raportin e saj të auditimit.

Për sa i përket këtyre rekomandimeve menaxhmenti i MSH-së ka adoptuar një plan veprimi i cili adreson në detaje rekomandimet e dhëna nga ne, data 18 Shtator 2009. progresi është arritur nga MSh në adresimin e rekomandimeve të dhëna, mirëpo ka ende shumë për tu bërë në kuptimin e implementimit të plotë.
Kemi vërejtur se: tre rekomandime janë implementuar, tre rekomandime janë implementuar pjesërisht apo janë në fazën e implementimit dhe dy rekomandime nuk janë adresuar.

Rekomandimi 1

Ministria e Shëndetësisë, në bashkpunim me institucionet shëndetësore, duhet të bëjnë një planifikim më të mirë dhe më të saktë lidhur me nevojat reale vjetore për barnat të listës esenciale.

Veprimet e ndërmarra

Nga analizimi (krahasimi) i planifikimit të QKUK-së (Depos Qendrore) me planifikimin nga MSH-ja tregon se planifikimi është bërë sipas nevojave të klinikave- reparteve, edhe pse nga krahasimi i sasive të kërkuara me ato të planifikuara shihet se planifikimet janë gjithmonë më të larta se kërkesat. Kërkesat janë 76% nga të planifikuarat.
Duke i krahasuar sasitë e sjellura (pranuara) kemi vërejtur se, barnat e pranuara janë 65% nga të planifikuarat.

Rekomandimi 2

Të gjitha kërkesat e bëra nga institucionet shëndetësore për furnizim me barna nga lista esenciale duhet të aprovohen nga Departamenti Farmaceutik para se të dërgohen tek kompania e kontraktuar për shpërndarjen e tyre.

Veprimet e ndërmarra

Ne kemi vërejtur se MSH- DF ende nuk i aprovon të gjitha kërkesat për barna nga Lista Esenciale. Kështu kërkesat e pa aprovuara nga MSH-DF të institucioneve shëndetësore shkojnë tek Kompania private, e cila është përgjegjëse për shpërndarjen e barnave. Përderisa këto kërkesa nuk aprovohen nga MSH është rreziku që të mos bëhet një verifikim i duhur i artikujve-barnave që kërkohen.

Rekomandimi 3

Departamenti Farmaceutik duhet të hetoj arsyet për dështimet e dukshme në zinxhirin furnizues të barnave esenciale.

Veprimet e ndërmarra

Kemi analizuar raportet vjetore të përgatitura nga barnatorja qendrore e QKUK-së duke e krahasuar sasinë e kërkuar me sasinë e pranuar gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2009 dhe

kemi vërejtur se 85% i e barnave të kërkuara janë pranuar. Një përmirësim prej (25%) në krahasim me vitin paraprak 12% është rezultat i rritjes së buxhetit dhe 13% është rezultat menaxhimit më të mirë. Gjatë tërë vitit 7% e barnave që janë kërkuar nuk janë pranuar.

Rekomandimi 4

Departamenti Farmaceutik duhet të nxjerr udhëzime për porositjen e barnave, përfshirë instruksionet për kalkulimin e nivelit të ri-kërkesës për çdo lloj medikamenti duke u bazuar në mesataren e përdorimit dhe kohën e drejtimit (procesi i porosisë dhe dërgesës).

Veprimet e ndërmarra

Është formuar Komisioni i cili sipas zyrtarëve të MSH është përgjegjës për të kompletuar dhe ndryshuar UA 2007/11- për barna të cilat në çdo kohë ato të jenë në dispozicion për pacientët. Bazuar në këtë që u lartpërmend dhe në faktet e ofruara përfundojmë se edhe Komisioni është formuar më vonë (13/05/2010) dhe kjo është në zhvillim e sipër.

Rekomandimi 5

Departamenti Farmaceutik duhet të sigurohet se është bërë ndarja adekuate e detyrave duke bërë që një individ nuk e ka plotësisht kontrollin mbi operimin e depos qendrore.

Veprimet e ndërmarra

Për sa i përket kësaj pike nuk ka pasur fare implementim sepse edhe vetë personi që ka qenë i autorizuar për detyrat përkatëse nuk ushtron më atë punë.

Rekomandimi 6.

Departamenti Farmaceutik duhet të siguroj që inventarizimi i pavarur i barnave esenciale në depon qendrore kryhet rregullisht.

Veprimet e ndërmarra

Ky rekomandim është përmbushur nga ana e MSh duke na ofruar edhe dëshmitë për inventarizimet e kryera nga grupet punuese.

Rekomandimi 7

Autoritetet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) duhet të ndërmarrin veprime për ta sjell depon në kushtet e pranueshme sipas standardeve për ruajtjen e barnave.

Veprimet e ndërmarra

Ky rekomandim është në fazën e hershme të implementimit ku parashihet që të rinovohet objekti i Repartit të gjinekologjisë e me të edhe depoja Qendrore e QKUK-së, e cila është e vendosur në podrumin e këtij reparti nga donatorët e huaj. Përzgjedhja e punë kryesit është në fazë n e tenderimit të cilin proces e udhëheq donatori në fjalë "Agjencia Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar TIKA".
Ndërsa gjendja deri në këtë moment mbetet ashtu si ka qenë-kushtet jo të mira për ruajtjen e barnave.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë që si pikënisje ne forcimin e procesit duhet të jetë qe te mbahen regjistrime se cilat barna dhe në çfarë sasie dhe çmimi janë dërguar te çdo pacient.

Veprimet e ndërmarra

Nga ekzaminimi që kemi bërë në klinikat të cila janë përgjegjëse për distribuimin e barnave deri te pacienti kemi vërejtur se në klinikat e ndryshme aplikohen metoda të ndryshme të shpërndarjes.
Në një klinikë gjëja e vetme që është regjistruar është e ashtuquajtura "Lista e temperaturës" ku përshkruhen të dhënat, diagnoza dhe terapia e pranuar nga pacienti. Nuk është e qartë nëse bari është blerë nga pacienti apo është marrë nga klinika, pavarësisht faktit se ai bar është në listën e barnave esenciale.
Duhet theksuar se në klinikën tjetër të vizituar kemi hasur gjendje më të mirë ku mbahen edhe librat e protokollit të pranimit dhe lëshimit të pacientëve. Në këto libra gjenden dhe informatat se kur është marr bari si dhe informatat nëse ai bar është blerë apo është marr në klinikë.
Kjo mënyrë e protokollimit lehtëson vetë punën e motrave kryesore por edhe len gjurmë për vajtjen e furnizimit nga momenti i pranimit të barit nga klinika e deri tek pranimi e atij bari nga pacienti. Sa i përket kësaj ne mendojmë se format e protokollimit do duhej të përdoreshin në të gjitha klinikat në mënyrë unike të standardizuar.

VI. Konkluzionet

Për sa i përket planifikimit (vlerësimit) të nevojave për barna nga lista esenciale, furnizimit dhe inventarizimit kemi hasur në përmirësim të gjendjes në lidhje me rekomandimet e dhëna . Kjo është arritur jo vetëm në saje të rritjes së buxhetit por edhe për shkak të menaxhimit më të mirë me barna në përgjithësi.

Si pjesë tjetër e rekomandimeve MSh-DF ka dështuar të bëjë implementimin e plotë të rekomandimeve të dhëna sa i përket aprovimit të kërkesave për barna nga Institucionet shëndetësore, nxjerrjen e udhëzimeve të brendshme të cilat do të ndihmonin ato që të

përcaktojnë minimumin e stoqeve për barnat esenciale dhe rekomandimin për shpërndarjen e barnave te pacienti.
MSH duhet të sigurojë një metodë unike në të gjitha klinikat që nga furnizimi deri te momenti i pranimit të tyre nga pacienti (librat e protokollit).